

ADVOCACY TRAINING AND RESOURCE CENTER



PËRMBAJTJA

Letër nga Drejtori Ekzekutiv	2
Paraqitje	3
Mision	3
Rreth ATRC-së	3
Historiku i ATRC-së	4
Përkrahësit	4
Partnerët	5
Programi për Trajnim, Konsulencë dhe Ngritje Kapacitetesh	6
Konsulencat Individuale	6
Programi për Menaxhim të Granteve	7
Programi për Avokim	9
Ri-bashkimi i Evropës nëpërmjet fuqizimit të sektorit të tretë	10
Lëvizja regjionale për ambient "BELLS"	10
Zgjidhja e Konfliktit Social	10
Pjesëmarrja e Publikut në Vendim-marrje	10
Debatet pas-zgjedhore lokale me Kryetarë të Komunave (Tetor 2008 - Shkurt 2009)	11
Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e Pyjeve (Shtator - Dhjetor 2009)	11
Projekti për Monitorimin e procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta (Qershor 2006- Dhjetor 2010)	11
Ambasadorët e Rinj në Mbrojtje të Mjedisit (Shtator 2009- Shtator 2010)	11
Zëri i Votuesve- debate para-zgjedhore lokale (Tetor 2009- Janar 2010)	12
Raporti i Auditimit	14
Programi për Informim	16
Buletini "Avokuesi"	17
Broshura	17
Ueb-faqja: www.advocacy-center.org	17
Bibloteka	17
Anëtarët e Bordit të ATRC-së	19
Personeli i ATRC-së	19

PËRSHENDETJE TË NDERUAR MIQ,

ATRC edhe këtë vit vazhdon me traditën e saj duke ju ofruar raportin përmbledhës të punës së saj vjetore.

Ky botim ofron një pasqyrim të aktiviteteve dhe të arritjeve kryesore të ATRC-së gjatë vitit 2009, si: projekteve të zbatuara, partneritetet e ndërtuara, projektet e administruara/financuara, trajnimet e mbajtura, konsulencat e ofruara etj.

Përmes këtij raporti si dhe raporteve tjera vjetore paraprake, ATRC synon jo vetëm rritjen dhe forcimin e komunikimit me organizata tjera partnere vendore dhe ndërkombetare dhe rritjen e transparencës së punës së saj, por edhe për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave në: fushën ngritjes së kapaciteteve për organizata joqeveritare dhe të tjere, procesin e administrimit të granteve, ofrimit të shërbimeve bazuar në kërkesat e përfituesve, zbatimin e projekteve avokuese në nivele lokal dhe nacional, organizimin e debateve etj, fusha në të cilat ATRC ka kontribuar në vazhdimësi dhe vazhdon të kontribuari edhe në periudhën në vazhdim.

Viti 2009 ka shënuar zhvillime të rëndësishme për ATRC-në, ndër të cilat mund të përmendim; ndërtimin e partneritetit me ISC-në për administrimin e granteve në kuader të programit të USAID "K-CSSP", krijimin e partneritetit rajonal me 5 organizata joqeveritare të 5 shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor me qëllim të implementimit të projektit rajonal mjedisor "BELLS", vazhdimin e partneritetit me The Olof Palme Center dhe UNHCR, organizimin e më se 30 debateve publike parazgjedhore në kuader të zgjedhjeve lokale të vitit 2009, organizimin e trajnimeve dhe ofrimit të një numri konsulencash për organizata joqeveritare lokale dhe ndërkombetare etj.

Angazhimet e vazhdueshme të fokusuar në forcimin e rolit të shoqërisë civile në proceset e përgjithshme vendimmarrese dhe avokimin në çështje të interesit të përgjithshëm, ATRC i orienton dhe i bazon në moton kryesore të saj: "bringing the advocate in everyone".

Besimi se vetëm njerezit e përgatitur dhe me vision mund të kontribuojnë në zhvillimin e brendshëm të organizatës dhe jashtë saj, ka motivuar ATRC-në që të investojë së pari në ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të punonjësve të saj të brendshëm në njërin anë si dhe në mbajtjen dhe ruajtjen e partnerëve të saj lokal dhe ndërkombetarë, në anën tjetër.

Sukseset dhe rezultatet e arrira nuk dotë mund të ishin të mundura pa stafin profesional, të përkushtuar, të përgatitur dhe me përvojë, i cili me të drejtë në Rregulloren e Punës së ATRC-së, konsiderohet si një nga pasuritë e saj.

Sinqerisht,
Kushtrim Kaloshi
Drejtore Ekzekutive



PARAQITJE

Misioni

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve në Avokim (ATRC) është organizatë Kosovare jo-fitimprurëse që punon në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendim-marrje, si parakusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe për stabilitet rajonal.

ATRC-ja punon me përfaqësues të organizatave jo-qeveritare (OJQ), iniciativa qytetare, administratën publike, institucione politike dhe media, pa dallim etnie, religjioni, përkatësie politike, aftësia, moshe, gjinie apo orientimi seksual. ATRC i arrin qëllimet e veta përmes ngritjes së kapaciteteve, avokimit, shkëmbimit të informatave dhe rrjetëzimit brenda dhe jashtë Kosovës

Rreth ATRC-së

Që nga themelimi në 2001, ATRC ka ndihmuar OJQ-të Kosovare në profesionalizim e punës së tyre, artikulimin e kërkesave të tyre dhe ka avokuar tek strukturat qeveritare për çështje me rëndësi për shoqërinë Kosovare. Andaj programet e ATRC-së janë të dizajnuara në atë mënyrë që tu përgjigjen nevojave të ndryshueshme të OJQ-ve Kosovare.

ATRC-ja arrin qëllimet e saja përmes administrimit të granteve, trajnimeve dhe konsulencave në tema të ndryshme si dhe organizimin dhe nxitjen e diskutimeve për çështje të shumta me rëndësi për qytetarët. Në të njëjtën kohë, synon të mbaj komunitetin e OJQ-ve të informuar duke ofruar burime të shumta të informatave, qoftë përmes ueb-faqes së saj apo

edhe përmes librarisë ku ofrohen publikime të shumta për çështje sociale, politike dhe ekonomike në Kosovë dhe rajon.

ATRC beson se ndërtimi i koalicioneve dhe partneriteteve ndër-sektoriale janë shtylla kyçe për arritjen e qëllimit dhe përmeshjen e misionit të saj. Për këtë arsye, ATRC është në bashkëpunim të vazhdueshëm me OJQ të shumta nëpër Kosovë, është pjesë e fushatave avokuese që kanë për qëllim zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe është pjesë e rrjeteve në nivel lokal, regjional e ndërkombëtar.

Historiku i ATRC-së

Gjate tri viteve të para të saja, ATRC ka qenë partnerë implementues i Projektit për Avokim të OJQ-ve Kosovare, projekt ky i financuar nga USAID dhe Instituti për Menaxhim Lindje – Perëndim (EWMI). ATRC përmes programeve të saja ka ndihmuar në ngritje të kapaciteteve të OJQ-ve, ka ofruar mbështetje në fushë të avokimit dhe ka ofruar mundësi për shkëmbim të informatave ndërmjet organizatave. Gjithashtu, ATRC ka qenë një nga organizatat pioniere që kanë avokuar tek autoritetet qeveritare për çështje si: komisionet e hapura parlamentare, zbatimin e ligjit për qasje në dokumente zyrtarë dhe ndryshimin e ligjit elektoral.

Në gjysmën e dytë të vitit 2005 ATRC fillon me implementimin e Projektit për Shoqëri Civile në Kosovë (KCSP), si partnerë lokalë i Bordit për Hulumtime dhe Shkëmbime Ndërkombëtare (IREX). Përmes këtij projekti tre-vjeçar të financuar nga USAID, ATRC ka arritur të zgjerojë spektrin e shërbimeve të saja dhe në këtë mënyrë të rrisë efektivitetin dhe ndikimin tek përfituesit e saj. Përveç programeve të lartpërmendura, ATRC që nga viti 2006 gjithashtu ka qenë partnerë implementues i UNHCR-it për projektin e monitorimit të Aeroportit të Prishtinës, projekt ky që ka për qëllim të monitorojë të gjitha rastet e kthimeve nga mërgata, qofshin ato vullnetare apo të detyruara.

Gjatë viteve 2007 dhe 2008, ATRC ka rritur përkushtimin e saj për të informuar e angazhuar publikun Kosovar në diskutime për çështje kritike që

i afektojnë ata drejtë për së drejti dhe duke u munduar në të njëjtën kohë që të afrojnë qeverinë tek qytetari. Si pjesë e kësaj strategjie ka qenë edhe iniciativa për informim të qytetarëve në nivel të Kosovës, rreth përmeshjes së pakos të dërguarit special të KB-së, Presidentit Ahtisari, për statusin e ardhshëm të Kosovës. Në vazhdim për një muaj, ATRC në bashkëpunim me 30 OJQ të tjera dhe Akademinë për Zhvillim Arsimor, kanë organizuar tryeza të rumbullakëta dhe takime me qytetarët në të gjitha komunat e Kosovës, ku kanë qenë të përfshirë zyrtarë të lartë qeveritarë, diplomatë të vendeve të Quintit dhe përfaqësues të shoqërisë civile për të shpjeguar dhe diskutuar përmeshjen e kësaj pakoje. Një iniciativë tjetër që gjithashtu ka tërhequr shumë vëmendje në vitin 2007, ka qenë debatet me kandidatët për kryetarë të komunës në kuadër të zgjedhjeve lokale. Këto debate të organizuara nga ATRC së bashku me BIRN-in, janë organizuar në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës dhe në këtë mënyrë i është dhënë mundësi qytetarëve të vlerësojnë vetë kandidatët edhe të marrin vendim të informuar në zgjedhjen e kryetarit të komunës së tyre.

Në vitin 2009, ATRC së bashku me tri organizata të tjera, janë shpallur partnerë lokalë të Projektit për Forcimin e Shoqërisë Civile në Kosovë (K-CCSP), projekt që financohet nga USAID dhe implementohet nga Instituti për Qëndrueshmëri të Komuniteteve. Gjithashtu, ATRC gjatë vitit 2009 ka zgjeruar sferën e saj të veprimit duke u angazhuar edhe në projekte për mbrojtje të ambientit, duke parë se kjo çështje me rëndësi globale ka mbetur e anashkaluar në Kosovë përkundër problemeve të shumta dhe nevojës së madhe për një qasje më serioze nga institucionet përkatëse.

Përkrahësit

Përkrahësit e ATRC-së gjatë vitit 2009 në implementimin e projekteve të saj kanë qenë:

- Agjensionin i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)
- Agjensionin i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtarë (SIDA)
- Ambasada Britanike në Prishtinë
- Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar (FCO)
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Prishtinë

- Ambasada e Holandës
- Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (ISC)
- Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
- Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)
- Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP)
- Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (UNHCR)

Partnerët

Gjatë vitit 2009 ATRC ka lidhur partneritete me organizata e institucione të ndryshme qeveritare dhe jo-qeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në përpjekje për t'i afruar qytetarët me vendim-marrësit. Partnerët kanë ndarë ekspertizën e tyre dhe kanë bashkëpunuar ngushtë me ATRC-në, në realizimin e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme.

- Komunat e Kosovës
- Drejtorit Komunale të Arsimit
- Instituti për Studime të Avancuara (GAP)
- Qendra Rajonale për Ambient (REC)
- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN)
- Swiss Kontakt
- Shoqata për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Grave (WSSI)
- Lëvizja Regjionale dhe Lokale BELLS
- Rrjeti Euklid

Lidhur me këtë raport

Raporti Vjetor 2009 u ofron përkrahësve, partnerëve dhe publikut një pasqyrë të punës dhe aktiviteteve të ATRC-së. Ky raport përshkruan aktivitetet e ndërmarra të ATRC-së duke filluar nga Janari e deri në Dhjetor të vitit 2009 në kuadër të katër programeve kryesore të ATRC-së: trajnim, konsulencë & ngritje kapacitetesh; informim; menaxhim grantesh dhe avokim. Në fund të këtij raporti mund të gjeni informata rreth raporteve financiare të ATRC-së. Ndërsa krejt në fund keni informata për personelin dhe kontaktet e tyre. Informata shtesë për ATRC-në mund të gjinden edhe në ueb faqen tonë: www.advocacy-center.org





PROGRAMI PËR NGRITJE KAPACITETESH

Ky program ka pas për qëllim t'iu ofrojë OJQ-ve metodat dhe mjetet e duhura për të iniciuar ndryshime tek komunitetet e tyre. Dita-ditës këto organizata ballafaqohen me sfida të reja dhe nevojat e tyre nuk janë të njëjta si më parë, andaj edhe ATRC ka ndryshuar programin e saj duke prezantuar trajnime më të avancuara dhe me tema të reja, në mënyrë që nevojat e përfituesve të saj të reflektohen në këtë program.

Gjatë vitit 2009, trajnerët e ATRC-së kanë realizuar 29 module trajnimesh prej të cilave kanë përfituar OJQ-të dhe institucionet e ndryshme, të të gjitha nacionaliteteve.

Programi i trajnimeve të ATRC-së përfshinë të gjitha temat e shënuara me poshtë:

1. Dizajnimi i projekt propozimeve (trajnim dy-ditor)
2. Menaxhimi i projektit (trajnim dy-ditor)
3. Menaxhimi i OJQ-ve dhe grumbullimi i fondeve (trajnim tre-ditor)
4. Hyrje në Avokim dhe Ndërtimi i Koalicioneve (trajnim dy-ditor)
5. Roli i OJQ-ve në Shoqëri Civile (trajnim një-ditor)
6. Qeverisja e mirë (trajnim një-ditor)
7. Liderhip dhe Menaxhim (trajnim dy-ditor)
8. Planifikim Strategjik (trajnim tre-ditor)
9. Analiza e Shpenzimeve (trajnim dy-ditor)
10. Monitorim dhe Vlerësim (trajnim një-ditor)
11. Relacionet midis Mediave dhe Shoqërisë Civile (trajnim dy-ditor)
12. Komunikimi Efektive (trajnim dy-ditor)

13. Orientimi i klientëve (trajnim dy-ditor)
14. Menaxhimi Financiar (trajnim një-ditor)
15. Relacionet me Publikun dhe Marketingu (trajnim dy-ditor)
16. Menaxhimi i Konflikteve (trajnim dy-ditor)
17. Negociata (trajnim dy-ditor)
18. Qeverisje me Pjesëmarrje të Publikut (trajnim dy-ditor)
19. Planifikim Kooperativë (trajnim dy-ditor)
20. Planifikimi i Buxhetit me Pjesëmarrje (trajnim dy-ditor)

Shënim: Për të gjithë klientët tanë, pagesat janë të standardizuara dhe janë të bazuara në kohën e kërkuar për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të trajnimit.

Konsulencat Individuale

Ndryshe nga trajnimet formale te cilat ju dedikohen një numri më të madh të individëve/organizatave, konsulencat janë të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të vetëm një organizate. Për këtë arsye, ATRC kombinon trajnimet me konsulenca individuale, për të përmbushur sa më mirë nevojat e çdo përfituesi dhe për të ngritë efektivitetin e programit të saj. Gjatë vitit 2009, janë zhvilluar 89 konsulenca individuale në sërë çështjesh që kanë të bëjnë me shkrim të projekt propozimeve, zhvillim organizativ, menaxhim dhe ngritje të fondeve.

Shënim: Konsulencat u janë ofruar falas OJQ-ve



PROGRAMI PËR MENAXHIM TË GRANTEVE

Në kuadër të “Projektit për Forcim të Shoqërisë Civile në Kosovë” të ISC-së, ATRC së bashku me Qendrën për Zhvillim të Shoqërisë Civile (CCSD) si dhe organizatat Komunikimi për Zhvillim Social (CSD) dhe Ardhmëria pa Frikë (FWF), kanë ndarë dhe administruar 18 grante OJQ-ve Kosovare, të dedikuara për avokim në nivel lokal. Gjatë vitit 2009, ka pasur dy thirrje për aplikim të cilat kanë qenë të publikuara në media të ndryshme të shkruara dhe elektronike; në të njëjtën kohë, personeli i ATRC-së së bashku me atë

të CCSD-së, kanë organizuar takime informative me OJQ-të e interesuara për t’iu ofruar informata më të detajuara rreth aplikimit dhe granteve.

Procesi i rishikimit të dhënies së granteve, është një proces i hapur dhe transparent, i cili realizohet nga një panel ekspertësh. Anëtarët e komisionit të granteve kanë qenë ekspertë të jashtëm dhe të pavarur, të cilët janë përzgjedhur në mënyrë të paanshme dhe në bazë të njohurive të tyre mbi sektorin e OJQ-ve e çështjeve zhvillimore në Kosovë.

Më poshtë ju ofrojmë një pasqyrë të shkurtë të të gjitha projekteve të cilat janë shpërblyer me grante gjatë vitit 2009:

- I. Emri i OJQ-së : Bethany Christian Services (BSC), Gjakovë, Titulli i Projektit: Pjesëmarrja e komunitetit RAE në implementimin e strategjisë për vitet 2009-2015, për integrimin e këtij komuniteti në Komunën e Gjakovës. Kohëzgjatja e projektit: 1 vit, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- II. Emri i OJQ-së: FORTESA, Kamenica, Titulli i Projektit: "Komunikimi mes qeverisë lokale dheqytetarëve, nëpërmjet këshillave lokal". Kohëzgjatja e projektit: 9 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- III. Emri i OJQ-së: Shoqata e të Verbërve dhe atyre me të Pamë të Dobësuar të Kosovës, Prishtinë, Titulli i projektit " E drejta për qasje të lirë". Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- IV. Emri i OJQ-së: Liria-i, Istog, Titulli i projektit "Ngrite zërin". Kohëzgjatja e projektit: 1 vit, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- V. Emri i OJQ-së: Shoqata e Personave me Paralizë të Fëmijëve, Handikap Kosova, Titulli i projektit "Monitorimi i implementimit të planit nacional të veprimit për persona me aftësi të kufizuara ". Kohëzgjatja e projektit: 1 vit, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- VI. Emri i OJQ-së: Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës (IQMQP), Titulli i projektit "Fushatë preventive kundër degradimit të qytetit të Prishtinës.", Kohëzgjatja e projektit: 1 vit, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- VII. Emri i OJQ-së: ELITA-Viti, Titulli i projektit "Komuna në shërbim të qytetarëve", Kohëzgjatja e projektit: 1 vit, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- VIII. Emri i OJQ-së: CDKD, Titulli i projektit "Mbrojeni Natyrën dhe Natyra do t'ju mbroj juve", Kohëzgjatja e projektit: 08 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- IX. Emri i OJQ-së : ANP
Titulli i projektit "Eja të ndryshojmë diçka", Kohëzgjatja e projektit: 12 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- X. Emri i OJQ-së: OON
Titulli i projektit "Asgjë mos bëni për ne, pa ne"
- Kohëzgjatja e projektit: 8 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XI. Emri i OJQ-së: SPERANZA, Mitrovicë. Titulli i projektit "Fushatë avokimi për ngritjen e kapaciteteve dhe punësimin e rasteve sociale". Kohëzgjatja e projektit: 09 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XII. Emri i OJQ-së YAHR, Lipjan
Titulli i projektit "Krijimi i mekanizmave për pjesëmarrje të komuniteteve të fshatrave në komunën e Lipjanit", Kohëzgjatja e projektit: 09 muaj projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XIII. Emri i OJQ-së: Futura Plus, Shterpce. Titulli i projektit: "Zyra shërbyese për qytetarë", Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XIV. Emri i OJQ-së: World of Angels, Mitrovica, Titulli i projektit "Ne kemi të drejtë për punë" Kohëzgjatja e projektit:12 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XV. Emri i OJQ-së: Klubi për politikë të jashtme, Prishtinë, Titulli i projektit: Kosova në internet Kohëzgjatja e projektit:6 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XVI. Emri i OJQ-së: Me dorë në zemër, Mitrovicë Titulli i projektit: Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në procesin vendimmarrës në nivelin komunal ndikon në qeverisjen e mirë. Kohëzgjatja e projektit:12 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XVII. Emri i OJQ-së: Shoqata e Gruas, Gjakovë Titulli i projektit: Përpilimi i "Rregullores për Eko - Taksat " në Komunën e Gjakovës, Kohëzgjatja e projektit:12 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010
- XVIII. Emri i OJQ-së: Shoqata e Gruas, Gjakovë Titulli i projektit: Përpilimi i "Rregullores për Eko - Taksat " në Komunën e Gjakovës. Kohëzgjatja e projektit:12 muaj, projekti vazhdon te implementohet edhe ne vitin 2010

PROGRAMI PËR AVOKIM



Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, ATRC zhvillon projekte që iniciojnë ndryshime në Kosovë. Programi për avokim gjithashtu siguron një platformë për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizëm me OJQ-të tjera nga Kosova dhe rajoni. Gjatë vitit 2009, ATRC ka qenë e përfshirë në këto projekte avokuese:

Ri-bashkimi i Evropës nëpërmjet fuqizimit të sektorit të tretë

Në prill të vitit 2008, Rrjeti Euklid filloi programin e saj për leadership në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi me përkrahje të Ministrisë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar (FCO) dhe në bashkëpunim me tre partnerë lokalë: ATRC-në (Kosovë), CEDEM-in (Mal të Zi) dhe HDPC-në (Shqipëri). Projekti ka për qëllim ngritjen e transparencës politike dhe qeverisjes së mirë në të gjitha shtetet e lartpërmendura, nëpërmjet fuqizimit të sektorit të tretë i cili do të jepte presion për një qeverisje më të mirë tek autoritetet përkatëse. Gjatë një periudhe 18 mujore të partneritetit mes ATRC-së dhe Euclid-it, janë zhvilluar një numër aktivitete të orientuara në ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, përmes vizitave studimore, hulumtimeve dhe analizave për sektorin e OJQ-ve në përgjithësi. Gjithë angazhimi është përmbledhur në një dokument të përbashkët: Kosovë, Shqipëri, Mal i Zi, të titulluar: "Prekja e Qiellit". Publikimi ka analizuar gjendjen reale të OJQ-ve në tria këto shtete dhe më pas ka tentuar të jap udhëzime në lidhje me mënyrën, praktikën dhe procedurat për aplikim në fondet e BE-së. Dokumenti më pas i është shpërndarë OJQ-ve përmes postës elektronike, me shpresë se informacionet e marra do t'i ndihmojnë sado pak në fazën e aplikimit me projekte tek fondet e BE-së.

Lëvizja regjionale për ambient "BELLS"

Lëvizja BELLS vjen si rezultat i projektit regjional për avokim për çështje të ambientit në shtetet Ballkanike (Regional Environmental Advocacy / REA Action and Cohesion in Western Balkans), që përkrahet nga Ambasada Mbretërore e Holandës. Përveç ATRC-

së, partnerët e tjerë implementues janë: "Instituti për Hulumtime Urbane -URI" (Tiranë), "Qendra për Ekologji dhe Energji" (Tuzël), "4x4x4 Urat Ballkanike" (Shkup), "Shtëpia e Gjelbër" (Podgoricë) dhe "Qendra për Aftësi Moderne" (Beograd). Ky projekt është në implementim e sipër dhe ka për qëllim ngritjen e vetëdijes të vendim-marrësve dhe akterve të tjerë me rëndësi, për nevojën e përmirësimit të legjislacionit për ambient dhe për vënien e kësaj çështje në agjendat kryesore parlamentare. Gjatë dy viteve të ardhshme do të realizohen një sërë aktivitete që do të fillojnë me një hulumtim kuantitativ dhe kualitativ dhe më pastaj do të ketë një fushatë avokimi në nivel të Kosovës për ambientin.

Zgjidhja e Konfliktit Social

Projekti për zgjidhje të konfliktit social ka për synim afrimin e qeverisë lokale me shoqërinë civile duke i pajis ata me metodat dhe mjetet për tejkalimin e konflikteve/problemeve mes tyre. Ky projekt i financuar nga Qendra Olof Palme, punon mbi bazën se bashkëpunimi i mirë mes shoqërisë civile dhe qeverisë lokale, do të jap rezultate më të mira në përbushjen e nevojave të komunitetit dhe pjesëmarrje më të madhe të publikut në vendimmarrje. Faza e parë e këtij projekti, që është realizuar në vitin 2008, ka trajtuar temat e zgjidhjes së konfliktit mes palëve dhe negociimi, gjë që ka hapur rrugën për fazën e dytë të projektit ku janë prezantuar tema si qeverisja më pjesëmarrje të publikut dhe planifikimi kooperues. Gjatë një periudhe katër mujore (mars – qershor), ATRC ka realizuar 10 trajnime në temat e lartpërmendura për përfaqësues të shoqërisë civile dhe qeverisë lokale të Prizrenit, Rahovecit, Malishevës, Therandës dhe Dragashit. Pas përfundimit të trajnimeve, në çdo komunë janë identifikuar nevojat dhe prioritetet e të gjitha komunave. Rezultatet e dala nga këto punëtori, janë bërë publike në konferencë për shtyp gjë që ka shtuar presionin tek autoritetet lokale për përfshirjen e këtyre rekomandimeve në planin strategjik të çdo komune.

Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje

Nëpërmjet këtij projekti të financuar nga Balkan

Trust for Democracy (BTD), ATRC ka synuar të risë pjesëmarrjen publike në proceset vendim-marrëse në Asamblenë Komunale të Prishtinës, posaçërisht në prioritizimin e investimeve kapitale dhe integrimin e mendimeve të qytetarëve në draft buxhetin për periudhën 2009/10. Për këtë arsye, ATRC ka vendos bashkëpunim me të gjitha bashkësitë lokale në Prishtinë dhe në bashkëpunim të ngushtë me ta dhe Asamblenë Komunale, ka implementuar të gjithat aktivitetet e projektit. Aktivitetet kryesore kanë përfshirë: një anketë me qytetarët në të gjitha bashkësitë lokale; takime me qytetarët dhe zyrtarët komunal dhe publikimi i një raporti në të cilën janë përfshirë të gjitha kërkesat dhe rekomandimet e qytetarëve për autoritetet e qeverisë lokale të Prishtinës.

Debatet pas-zgjedhore lokale me Kryetarë të Komunave (Tetor 2008 - Shkurt 2009)

Gjatë zgjedhjeve lokale dhe parlamentare të vitit 2007, ATRC-ja së bashku me BIRN-in dhe GAP-in organizuan debate publike mes qytetarëve dhe kandidatëve për kryetarë komune në 27 komuna të Kosovës. Meqenëse këto debate patën shënuar një numër rekord të shikuesve (gjysmë milioni) dhe premtimet e dhëna nga kandidatët kanë qenë të shumta, pati një interesim të madh nga qytetarët që këta kryetarë të ballafaqohen sërish me elektoratin e tyre, dy vjet pas marrjes të postit. Për këtë arsye ATRC, me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike së bashku me partnerin e saj, sërish organizoi një cikël debatesh, në po të njëjtat komuna, me qëllim të vlerësimit të punës dhe progresit të arritur nga kryetarët që patën dhënë premtime të shumta gjatë fushatave para-zgjedhore. Të gjitha debatet janë emituar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), në kuadër të emisionit "Jeta në Kosovë".

Sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e Pyjeve (Shtator - Dhjetor 2009)

Fatkeqësisht, gjatë viteve të fundit shumë e më shumë pyje janë dëmtuar dhe mbrojtja e tyre ka qenë dobët e menaxhuar. Andaj edhe nevoja për këtë projekt – të implementuar nga ATRC-ja dhe financuar nga Ministria për Bujqësi- që ka për qëllim

informimin dhe edukimin e qytetarëve të Kosovës për rëndësinë dhe mbrojtjen e pyjeve. ATRC së bashku me Departamentin për Pylltari kanë realizuar një sërë aktivitetesh në qytetet e Podujevës, Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Gjakovës për të ndihmuar në parandalimin e shkatërrimit të pyjeve dhe për të ngritur vetëdijen tek popullata për pasojat e një veprimi të tillë. Fushata ka pasur aktivitete të shumta, që kanë përfshirë: takime me qytetarët; ligjërata dhe debate me nxënës; tryeza të rumbullakëta me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve, zyrtarë komunalë dhe shoqatat e gjuetarëve; takime informative me bizneset private që operojnë në afërsi të pyjeve për t'i shpjeguar ligjet në fuqi dhe obligimet e tyre për respektimin e tyre.

Projekti për Monitorimin e procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta (Qershor 2006- Dhjetor 2010)

Projekti për monitorimin e Aeroportit të Prishtinës, i cili operon nën ombrellën e ATRC-së dhe financohet nga UNHCR, monitoron kthimet e detyruara dhe vullnetare për në Kosovë dhe regjistron të gjithë azil kërkuesit të cilët arrijnë në vendin tonë. Përmes këtij projekti, ekipi monitorues i ATRC-së arrin të identifikojë të gjitha rastet të cilat janë kthyer në mënyrë të detyruar apo vullnetare. Në këtë mënyrë ekipi për monitorim ndihmon UNHCR-në në përcjelljen e trendëve të të kthyerve në Kosovë dhe qëndrueshmërinë e këtyre kthimeve. Gjithashtu, ky projekt ndihmon në identifikimin e rasteve të cenueshme, duke i referuar ato autoriteteve dhe organizatave përkatëse apo duke ofruar strehim për ata që kanë nevojë..

Ambasadorët e Rinj në Mbrojtje të Mjedisit (Shtator 2009- Shtator 2010)

Edhe pse Kosova ka probleme të mëdha me ambientin, prapë se prapë kjo çështje nuk tërheqë vëmendjen e duhur dhe iniciativat në atë drejtim janë të mangëta. Projekti i ambasadorëve të rinj për ambientin, i financuar nga Ambasada Amerikane dhe implementuar nga ATRC synon të ngritë vetëdijen institucionale dhe kapacitetin për përhapjen e poli-

tikave të qëndrueshme për ambientin në 30 komuna të Kosovës. Çdo komunë do të ketë 300 ambasadorë të rinj që do të ndërmarrin fushata dhe aktivitete për mbrojtjen e ambientit në çdo komunë. Projekti do të vazhdojë gjer në Shtator të vitit 2011 dhe gjatë kësaj kohe ATRC parasheh të realizoj një sërë aktivitete, si: ligjërata për mbrojtjen e ambientit, shpërndarje të granteve të vogla si dhe trajnime për të ndihmuar ambasadorët e rinj në organizimin e fushatave të suksesshme të avokimit.

Zëri i Votuesve- debate para-zgjedhore lokale (Tetor 2009- Janar 2010)

Duke kujtuar suksesin e madh të debateve të organizuara në të kaluarën, BIRN, ATRC dhe GAP sërisht kanë bashkuar forcat e tyre për të prodhuar edhe një cikël debatesh, kësaj radhe për zgjedhjet 2009. Debatet kanë qenë të parapriura nga një hulumtim i gjendjes socio-ekonomike në çdo njëri nga komunat dhe gjithashtu janë realizuar anketa me qytetarët për të kuptuar se cilat janë problemet kryesore që i preokupojnë ata. Debatet para zgjedhore që kanë për qëllim ngritjen e përgjegjshmërisë dhe llog-

ari-dhënies të qeveritarëve ndaj qytetarëve, janë organizuar në 30 komuna dhe transmetuar në RTK, në kuadër të emisionit "Jeta në Kosovë".





RAPORTI I AUDITIMIT





INDEPENDENT AUDITORS' REPORT

To the Board of Directors of Advocacy Training and Resource Centre

We have audited the accompanying financial statements of Advocacy Training and Resource Centre - ATRC, which comprise the balance sheet as at December 31, 2009, and the statement of revenue and expenditure, statement of changes in net assets and cash flow statement for the year then ended, and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with Kosovo Accounting Standards. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparation and fair presentation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

In our opinion, the financial statements referred to above present fairly, in all material respects, the financial position of ATRC as of December 31, 2009 and the results of its operation for the year then ended in conformity with accounting principals generally accepted in Kosovo.


Armend Osaj – Licensed Auditor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtina, Kosova
January 2010





PROGRAMI PËR INFORMIM

Programi i ATRC-së për informim, mbështetë shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe ueb-faqes së ATRC-së. Diskutimet publike, shpesh të organizuara në bashkëpunim me OJQ të tjera, synojnë të informojnë qytetarët & organizatat e shoqërisë civile për çështje të rëndësishme që kanë ndikim në jetën e tyre, të ofrojnë forum për këmbim përvojash dhe idesh, të ofrojnë ekspertizë në fusha të ndryshme dhe mundësi rrjetëzimi për OJQ-të.

Gjatë vitit 2009, ATRC ka organizuar 65 ngjarje të ndryshme publike, që kanë trajtuar çështje sociale, ekonomike dhe politike. Faqja e internetit të ATRC-

së dhe broshurat sjellin një tjetër informacion të portalit për gjithë përfituesit e tij dhe të palëve të interesuara, në faqen e internetit ka pasur 17.229 klikime. Ne 2009 ATRC ka publikuar dy udhëzues, e para "Udhëzues për përkrahje financiare të OJQ-ve në Ballkanin Perëndimor" e përkrahur nga Ministria e Jashtme e Mbretërisë së Bashkuar (FCO) që jep informata të qarta rreth procedurës së aplikimit për fonde në Bashkimin Evropian; dhe udhëzuesi i dytë: "Nevojat dhe prioritetet e regjionit të Prizrenit" e përkrahur nga Qendra Olof Palme, që synon të ndihmojë komunitetet e regjionit të Prizrenit në dizajnimin e planeve duke u bazuar në nevojat e qytetarëve. Të dy udhëzuesit mund të gjinden në ueb faqen tonë: www.advocacy-center.org që rishtazi është ri-dizajnuar dhe ku mund të gjinden informata në të tria

Buletini "Avokuesi"

ATRC ka vazhduar publikimin e buletinit elektronik mujor "Avokuesi" i cili permban udhezime dhe informata praktike te cilat OJQ-te dhe grupet e tjera te interesuara mund t'i perdorin gjate punes se tyre. "Avokuesi" u është dërguar në mënyrë elektronike qindra OJQ-ve, mediave, institucioneve qeveritare, agjensive ndërkombëtare dhe përkrahësve potencial në dhe jashtë Kosovës. "Avokuesi" publikohet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe ndoshet në ueb-faqen e ATRC-së: www.advocacy-center.org

Broshura

Në vitin 2009, ATRC ka publikuar broshurë tv re me të cilen ofrohen informata të shkurtra dhe gjithëpërfshirëse për profilin, aktivitetet, shërbimet dhe resurset e kësaj organizat. Broshura mund të shkarkohen në ueb-faqen www.advocacy-center.org

Ueb-faqja: www.advocacy-center.org

ATRC ka ridizajnuar ueb-faqen duke e bërë atë më të përshtatshme për shfrytëzuesit në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në vitin 2009, ueb-faqja është vizituar 17.229 herë

Bibloteka

Bibloteka e ATRC-së posedon më shumë se 1.060 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, lidërsip, të drejtat e njeriut, mjedis, vetëdijësim gjinor, etj. Bibloteka është e hapur për OJQ lokale dhe ndërkombëtare, studentë, gazetarë, punonjës në qeveri dhe qytetarë të interesuar.





ANËTARËT E BORDIT TË ATRC-së

KRESHNIK BERISHA

Themelues i ATRC-së
Kryetar i Bordit

ADRIANA KABASHI

Redaktore në RTK
Nënkryetare e Bordit

VJOSA MULLATAHIRI

Menaxhere e Projektit në UNDP
Anëtare e Bordit

Prof. Dr. ISA ELEZAJ

Profesor në Fakultetin e Shkencave Natyrore në UP
Anëtarë Bordi

NAIM RASHITI

Hulumtues /Menaxher i zyrës në ICG
Anëtarë Bordi

PERSONELI I ATRC-së

Drejtor Ekzekutiv

Kushtrim Kaloshi

kushtrimk@advocacy-center.org

Drejtor i Programeve

Donika Podrimja-Salihu

donika@advocacy-center.org

Menaxher i Financave dhe Administratës

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Menaxhere e Programit të Trajnimeve dhe
Konsulencave

Nora Susuri

nora@advocacy-center.org

Koordinatorë e Projektit

Shukrije Rama

shukrije@advocacy-center.org

Asistente e Projektit

Sanije Guxhufi

sanije@advocacy-center.org

Asistente e Projektit

Bojana Delibasic

bojana@advocacy-center.org

Koordinatorë e Ekipit për Monitorimin e të Kthyerve

Emine Emini

emine_e@advocacy-center.org

Monitorues

Gëzim Kunoviku

gezim@advocacy-center.org

Monitorues

Hysen Hamzaj

hysen@advocacy-center.org

Monitorues

Zaid Kulinxha

zaid@advocacy-center.org

TI & Administratë

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Asistente Administrative

Jehona Tmava

jehona@advocacy-center.org

INFORMATAT KONTAKTUESE

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim

Tel/fax: +381 38 244 810

info@advocacy-center.org

www.advocacy-center.org

Lokacioni i ATRC-së

Rruga. Gazmend Zajmi, No. 20, Prishtina, Kosovo



Ky raport u mundesua nga kontributi i stafit te ATRC-se.
Permbajtja e ketij publikimi eshte pergjegjesi e ATRC-se.

Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2009, ATRC -Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Prishtinë - Kosovë
ATRC Raporti Vjetor 2009 përgaditur nga stafi i ATRC-së.

CONTENTS

Letter from the Executive Director	2
Introduction	3
Mission	3
About ATRC	3
ATRC History	4
Supporters	4
Partners	5
About this Report	5
Capacity Building Programme	6
One to One Consultancies	6
Grant-Giving Programme	7
Advocacy Programme	9
Building from Within: Reuniting Europe by Strengthening and Connecting the Third Sector	10
Regional Environmental Advocacy: BELLS Movement	10
Multilevel Social Conflict Resolution	10
Public Participation in Decision-Making	10
Post Municipal Election Debates (October 2008 until mid-February 2009)	11
Raising Public Awareness on Forest Protection (September - December 2009)	11
Returnee Monitoring Project (June, 2006- December 2010)	11
Young Environment Ambassadors	11
Voice of the Voters (October 2009- January 2010)	12
Financial Report	14
Information Program	16
Newsletter and Brochure	17
Website	17
Library	17
Board Members	19
Staff and Contact Information	19

DEAR FRIENDS

